

Zgjedhjet Studentore 2024 - Njoftim publik për studentët

Bazuar në Rregulloren mbi Zgjedhjet Studentore, iu njoftojmë se me rastin e aplikimit Organizatat Studentore duhet të paraqesin:

- Aplikacionin për certifikim, i cili merret në Universitet, në zyrën numër 008.
- Licencën e regjistrimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.
- Statutin e Organizatës Studentore.
- Formularin e deklaratave mbështetëse me nënshkrime. Formulari me të dhënat e studentëve që kanë mbështetur organizatën studentore duhet të plotësohet edhe në formë elektronike në excel. Formulari merret në zyrën numër 008.
- Përcaktimi i të adresuarit të autorizuar të Organizatës Studentore.

Organizatrat Studentore që garojnë në zgjedhjet studentore 2024, duhet të regjistrohen, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike dhe KQZ të UShAF.

Regjistrimi bëhet nga data 07.02.2024 deri 12.02.2024.

Certifikimi i Organizatave Studentore do të bëhet me datën 12.02.2024.

Ju njoftojmë gjithashtu se listat e kandidatëve të nominuar nga Organizatat Studentore të certifikuar, në pajtim me Rregulloren mbi Zgjedhjet Studentore dhe dinamikën e zgjedhjeve, certifikimi i kandidatëve të nominuar bëhet me datën 13.02.2024. Dorëzimi i listave bëhet në zyrën numër 008. Formulari i listave mund të merret në të njejtën zyrë.

Zgjedhjet studentore do të mbahern me datën 22.02.2024.

Sqarim shtesë lidhur me numrin e deklaratave mbështetëse për certifikim:

Organizata Studentore që regjistrohet për herë të parë dhe që siguron së paku 100 nënshkrime të studentëve të UShAF, fiton të drejtën të radhitet në organizatë studentore konkurrenente për zgjedhjet studentore për Parlamentin Studentor.

Organizatrat Studentore të cilat nominojnë kandidatët për anëtarë të Parlamentit Studentor, përveç formularit të nënshkruar duhet të kenë edhe deklaratat e nënshkruara për pranim të kandidaturave.

Njoftohen Organizatat Studentore, të cilat në zgjedhjet e mëparme kishin numër më të madh të votave të fituara se janë të obliguara që të sjellin nga një anëtarë në Komisionin Zgjedhor në cilësi të vëzhguesit por pa të drejtë vote.

Kryesuesi i KQZ
Armend Hysa


